



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 161 Prot.

Tiranë më 30 / 7 /2018

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 30.07.2018 në orën 17:30, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) sipas njoftimit u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të kryetares së Bordit Mbikqyrës ishte:

1. Diskutim lidhur me Projekt Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) "Strategjia Antikorrupsion"
2. Diskutim mbi mundësinë e Thirrjes 12.
3. Diskutim mbi mundësinë e diversifikimit të fondeve në kushtet e reja

Në mbledhje të pranishëm ishin anëtarët si më poshtë:

1. Znj. Kozara KATI
2. Znj. Majlinda DHUKA
3. Z. Adrian THANO
4. Z. Endri FUGA
5. Z. Oltjon MUZAKA
6. Znj. Gelardina PRODANI
7. Z. Ismail ADEMI

Në mungesë dhe me porosi të Drejtorit Ekzekutiv të AMShC-së, Z. Andi Kananaj në mbledhje ishte i pranishëm Z. Erion Banushi, Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve.

Znj. Kati deklaroi të hapur mbledhjen duke prezantuar rendin e ditës dhe më pas fjalën e mori Z. Banushi i cili sqaroi Burdën se rreth muajit dhjetor përfaqësues të AMShC-së kanë pasur një takim me disa përfaqësues të KLSH-së dhe është diskutuar në lidhje me disa pika të strategjisë antikorrupsion. AMShC është përgjigjur në lidhje me kërkesat e tyre për informacion edhe në rrugë shkresore. Në

përfundim të auditimit nga ana e tyre është dërguar një shkresë përcjellese dhe bashkangjitur projekt-raporti i auditimit të performancës sipas të cilit megjithëse AMShC nuk është subjekt i drejtpërdrejtë i këtij auditimi ata janë shprehur dhe në lidhje me institucionin tonë dhe si gjetje e tyre ka qënë mospërgjigjia e disa prej organizatave si dhe mosregjistrimi i tyre në databazën e AMShC. Nëpërmjet një shkrese u është shpjeguar grupit të auditimit se në bazë ligjore AMShC ka detyrim të mbajë kontakt vetëm gjatë periudhës kur organizata zhvillon projektin.

Anëtarët e Bordit pasi informohen diskutojnë në lidhje me këtë çështje.

Sipas Znj. Dhuka duhet të shohim rekomandimet dhe duhet të kemi parasysh që gjithësesi Auditimi i performancës është i ndryshëm nga auditimi financiar ndaj të shihen me kujdes nga stafi i AMShC-së gjetjet dhe të ndërmerret një plan strategjik në bazë të të cilit të bëhet një raport dhe të diskutohet në takimin e radhës.

Znj. Prodani shprehet që nëpërmjet një kërkesë zyrtare në QKB dhe Tatime të shohim nëse janë ose jo aktive këto OJF për të cilat ngrihen dyshime.

Z. Fuga shprehet se një rrugëzgjidhje është edhe që AMShC të vendoset në kontakt me këto organizata nëpërmjet postës elektronike dhe më pas lista bashkë me përgjigjet e tyre t'i behet me dije KLSH-së.

Në përfundim të diskutimit të gjithë anëtarët ranë dakort dhe i lanë si detyrë AMShC-së të hartojë një planveprim për t'u vendosur në kontakt me keto OJF dhe të bëhet raportim ne organin përkatës.

Znj. Kati kalon në pikën e dytë të takimit, e cila ka të bëjë me Thirrjen nr. 12, fondet e mbetura, fondet ekstra si dhe të përcaktohen prioritetet.

Pas një pasqyrimi të disponibilitetit financiar, hartuar nga stafi i AMSHC-së, duke konsideruar shumën e vogël në dispozicion, shumica e anëtarëve të pranishëm të Bordit ranë dakort për mos hapjen e një thirrje shtesë për projekt propozime gjatë vitit 2018.

Në vijim, Kryetarja e Bordit Mbikëqyrës të AMShC-së kaloi në pikën e fundit të rendit të ditës mbi diskutimin e diversifikimit të fondeve në kushtet e reja.

Mbledhja deklarohet e mbyllur në orën 19:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Kozara KATI

Kryetare

Majlinda DHUKA

Zëvendës Kryetare

Alban DUDUSHI

Anëtar

Oltjon Muzaka

Anëtar

Aldo MERKOCI

Anëtar

Endri FUGA

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtare

Ismail ADEMI

Anëtar

Adrian THANO

Anëtar